

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : **AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	97500-25-1681-2-1-1
------------------	---------------------

Sa i përket tenderit për **Rregullimi dhe mirembajtja sanitare e objekteve shkollore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SMART ENG GROUP SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Brigada 123, p.n.

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349220599

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Astrit Tahiri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

eng.smart2021@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.07.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontratë – 18.03.2025
Hapja e ofertave – 28.04.2025
Njoftimi mbi vendimin – 15.05.2025
Kërkesa për ri shqyrtim 19.05.2025
Vendimi i AK-se – Aprovimi pjesëshem – 21.05.2025
Njoftimi mbi vendimin e AK-se, anulimi i procedurës – 17.06.2025
Kërkesa për ri shqyrtim 23.06.2025
Vendimi i AK-se – Refuzimi i kërkesës 24.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Hapja e ofertave – 28.04.2025

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e më tutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Operatori Ekonomik ankues – lideri i grupit, “Smart En Group” shpk, ndaj kesaje procedure te prokurimit, bazuar ne dispozitat e nenitn108/A, te LPP-se, ka parashtruar kerkese për ri shqyrtim te vendmit, janë prezantu fakte për shkelje ligjore dhe shkelje te parimeve te prokurimit publik.

Pavaresisht kesaje, zyra e prokurimit dhe zyrtaret përgjegjës te saje me vendmin e datës 24.06.2025, ka refuzuar kerkesen dhe lane lejuar te procedohet tutje pavaresisht shkeljeve ligjoreedhe pse pa e trajtuar asnjerin nga pretendimet tona ankimore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji me nr. 04/L-042, per Prokurim Publik

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

Neni 130 – Ndikimi i paligjeshëm.

Rregullorja me nr. 001/2022, per Prokurim Publik

Neni 40- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 97 – Shkeljet e renda te LPP-se

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Autoriteti Kontraktues – Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, për këtë procedurë të prokurimit, si në vlerësim fillestar po ashtu edhe në ri vlerësim ka konsumuar skelje ligjore nga ligji për prokurim publik, si rrjedhojë veprimet e komisionit vlerësues dhe ri-vlerësues, janë jo ligjore dhe jo parimore, ku tani tentohet të anulohet procedura e prokurimit edhe pse në kundërshtim me secilën dispozitë ligjore të nenit 62, të LPP-se dhe në kundërshtim me gjendjen faktike të ofertës sonë.

Lideri i grupit të OE-ve ankues, bazuar në dispozitat e nenit 108/A të LPP-se me kërkesë për ri shqyrtim ka prezantuar fakte dhe dëshmi për eliminim të kundershtueshmërisë të ofertës sonë por AK, me vendimin e sajë perseri refuzon kërkesën dhe le në vuqi vendimin e sajë anë pse i kundershtueshmërisë, andaj bazuar në dispozitat e nenit 109, të LPP-se, paraqesim argumentet tona si më poshtë:

Pretendimi ankimor 1.

Në njoftimin mbi vendimin e AK-se – Formularin B58, të datës 17.06.2025, AK, ka potencuar se: *”AK Anulon këtë procedurë të prokurimit pasi që nuk kemi asnjë ofertë të përgjegjshme”*, ndërsa në leter standarde ndaj ofertës sonë keni potencuar se jemi diskualifikuar dhe atë:

- 1. Keni sjellë vendim për menaxherinë projektit i cili është i diplomuar si ekonomist mirepo jo në fushën e menaxhimit ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit*
- 2. OE në ofertë ka prezantuar Arkitekt, ndërsa në dosjen e tenderit është kërkuar Arkitekt bachelor ose master i diplomuar në arkitekturë dhe Planifikim Hapsinorë dhe se përvoja e punës nuk është 3 vite por 13 muaj*
- 3. Ju si OE keni ofruar çmime jashtëzakonisht të larta dhe jo çmime të tregut për shumicën e pozicioneve.*

Ky arsyetim i eliminimit në vlerësimin fillestar nuk ka qenë i përshkruar, si rrjedhojë e kësajë AK, me vlerësim të tillë të njëanshëm ka konsumuar shkelje ligjore të dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik dhe parimeve, të po të njëjtit ligj vetëm pse ishte e pamundur lidhja e kontratës me kompaninë e para përcaktuarë cila edhe në vlerësim fillestar ishte favorizuar madje oferta e tijë fare nuk ishte vlerësuar.

Madje AK, zyra e prokurimit nuk e ka prezantuar gjendjen faktike as të ofertës sonë dhe as të ofertës tjetër e cila ishte rekomanduar kundershtueshmërisë në procedurë fillestare të vlerësimit të ofertave dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat edhe të nenit 108/A të LPP-se.

Në vendimin e datës 24.06.2025, ku është refuzuar kërkesa jone si e pa bazuar AK, nuk ka marrë mundin fare për të trajtuar asnjërin nga pretendimet tona ankimore, përkatësisht në përgjigje në pretendime është potencuar se: *“Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim*

për te Rritur, vlereson se pretendimet ankimore kundër vendmit për anulim janë të pa bazuara. Mbetet ne fuqi vendmi i datës 17.06.2025”.

Trajtimi si i tillë konsumon shkelje ligjore të nenit 108/A, të LPP-se nga paragrafet 8 dhe 9 të LPP-se, si rrjedhojë bazuar në këto dispozita AK, perkates nuk mund të refuzoj një kerkese nese nuk i ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kerkese për ri shqyrtim dhe nuk mund të refuzoi një kerkese pa i sqatrat dhe pa vendosur lidhur me atë çfare është kerkuar nga OE.

Ngjashëm është vepruar edhe në kerkesen paraprake ku në si OE kemi prezantuar fakte për oferte fiktive dhe dokumente jo reale të ofertës së propozuar në vlerësim fillestar, të njejtat fakte janë mohuar dhe nuk janë trajtuar nga AK., si rrjedhojë në leter standarde në procedure të ri vlerësimit të ofertave të njejtat qeshtje nuk janë pasqyrtuar, perderisa ndaj ofertës sonë janë shtuar arsytetime të reja të eliminimit.

Pretendmie ankimore 2

Sa i përket arsyetimit të eliminimit të kompanisë sone autoritet kontraktues qellishem ka deformuar kerkesat kualifikuese të vetë percaktuara dhe tenton të eliminoi me doemos ofertën tone si të pa përgjegjeshme ani pse neve si OE i kemi plotësuar të gjitha kerkesat e dosjes së tenderit.

Menaxheri i projektit z. Ymer Kushaj, e plotëson në tërësi kerkesen e përcaktuar nga AK. Në oferte kemi prezantuar diplomën e z. Kushaj, kemi prezantuar CV dhe leter referencat e të njejtit ku argumentohet se i njejtë ka menaxhuar projekte të natyrës së aktivitetit të prokurimit dhe si tërësi janë prezantuar prova dhe dëshmi përmes të cilave konfirmohet se AK, kunderligjeshem tenton të eliminoni kompaninë tone.

Ngjashëm është vepruar edhe me arsyetimet tjera të eliminimit, perkateishst z. Zenuni, posedon kualifikimin profesional Masteri i shkencave të arkitektures ku i njejtë ka mbrojtur diplomën me datën 04.08.2020, perderisa studimet themelore i ka përfunduar, vite më parë. Ngjashëm qëndron fakti edhe me z. Feka janë prezantuar fakte dhe prova me të cilat mbulohet kerkesa kualifikuese e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Të gjitha këto konfirmohen me kualifikime profesionale, me CV dhe referenca të cilat janë deformuar dhe janë paraqitur si të teilla në leter standarde – arsyetimet e eliminimit.

Me kerkese kualifikuese, me rregulla ligjore, përvoja e punës fitohet pas datës së diplomimit dhe AK nuk mund të lejohet të deformoi gjendjen faktike sa i përket kualifikimeve të stafit tone dhe përvojes profesionale të stafit të prezantuar në oferte.

Pikërisht për keso qeshtjesh përveq bazës ligjore ekzistojnë vendime të OSHP-se, opinione të KRPP-se dhe vendime tjera ku qëllimshem AK tenton të anuloi procedurën ani pse në ofertën e OE ankues janë të ngarkuara të gjitha provat dhe dëshmitë konform kerkësive të aplikuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Pretendmi ankimore 3.

Arsyetime tjetër të eliminimit, sa i përket qeshtjes së çmimeve jo në harmoni me tregun, kjo është vetëm arsyetim për të anashkaluar ofertën tone dhe për të eliminuar të njejtën pa

kurrefare baze ligjore. E gjithë oferta jone është ne harmoni me tregun ne harmoni me dispozitat ligjore dhe brenda vlerës se parashikuar nga AK.

Për me tepër lidhur me cmimet e tilal te pretenduara AK, as pergjate vlerësimit por as pergjate ri vlerësimit ndaj ofertës sonë nuk keni aplikuar dispozitat e nenit 61, te LPP-se dhe nuk ka kerkuar kurrefare sqarim, si rrjedhoje eliminimi i tille konsiderohet si shkelje e rende ne LPP dhe shkelje e parimeve te prokurimit publik.

Te gjitha këto veprime bien ndesh me nenin 59, par 4, ku kjalet percaktohet qe:

“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit...”

Autoriteti kontraktues dhe zyrtaret pergjegjes te prokurimit ne rastin kur grupi i Operatoreve Ekonomik, te propozuar për dhenien e kontratës sipas vlerësimit fillestare, ne oferte kan prezantuar kontraten e lidhur me datën 23.07.2024, me z. Ruzhdi Feka, kontrate kjo e bashkangjitur ne oferte për te plotesuar kerkesen kualifikuese dhe ate ne cilesine e ekspertit për siguri dhe shendet ne pune, përkatësisht konfirmimit te prezantuar nga kompania jone se z, Feka për këtë projekt është pjese e stafit tone dhe askujt tjetër, ka qene dashur te trajtohej dhe jo te fshihej.

Ofertat e tilla, vleresimet e tilla te njeaneshme dhe jo objektive, kane pasoja serioze ligjore ne prokurim publik dhe janë tipike veprime penale te sanksionuara me KPK, si rrjedhoje dispozitat ligjore obligojne inicimin e procedurës ashtu siç percaktohet me nenin 99.2, te LPP-se, për ndermarrje te veprimeve ligjore ne OSHP, perkateissht mos ndermarrja e veprimeve ligjore konsumon shkelje edhe te nenit 130, te LPP-se, qe qon ne pergegjesi ligjore dhe penale.

Neve si OE te demtuar ne këtë procedure te prokurimit, pas qasjes ne ofertene grupit te OE te propozuar për dhenien e kontratës ne vlerësim fillestare i jemi drejtuar me shkrese z. Feka, pasi qe kompania jone e ka te kontraktuar te njejtin pikerisht për këtë procedure dhe me datën 17.05.2025, kemi marre konfirmim se z. Ruzhdi Feka nuk është i angazhuar ne asnje kompani tjetër lidhur me këtë procedure te prokurimit. Për këtë qeshjte AK, është ne dijeni dhe nuk ka ndermarr kurrefare veprimi perkundrazi ne leter standarde mbi arsyet e eliminimit fare nuk e keni prezantuar këtë fakt dhe tentoni te tejkaloj ne heshtje. Te gjitha këto veprime konfirmojne se kompania e propozuar paraprakisht me AK, dhe zyrtaret përgjegjës te prokurimit janë te perfshire haptazi me veprime kundërligjore dhe tentativa për abuzim me parane publike është evidente.

Te gjitha faktet e sipër prezantuara, tregojne për favorizim, për vlerësim te njeaneshme dhe pa i perfillur kerkesat e percaktuara ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate, prandaj ne si operator ekonomik, përkatësisht lideri i grupit, përmes kesaje ankese kërkojmë nga OSHP, qe për trajtim te kesaje ankese ti ndermerr te gjitha veprimet ligjore dhe te autorizoi ekspert

shqyrtues profesional i cili bazuar ne dispozitat ligjore te nenit 113 dhe 114, te LPP-se i trajton ne perpikmeri pretendimet ankimore, e pasqyrton qarte gjendjen faktike ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerrni këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohet**, e bazuar ankesa e OE “Smart Ing Group” shpk,
- II. **Anulohet**, njoftimi i datës 17.06.2025, formulari B58, propozimi për anulimin e aktiviteitit te prokurimit dhe lënda kthehet ne **Ri-vlereim**.
- III. **Kualifikohet**, si e pergjegjeshme oferta e OE ankues “Smart Ing Group shpk
- IV. **Lejohet**, kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses.

Ne si kompani me doemos do ti ndermarrim edhe veprimet tjera ligjore pasi qe haptazi AK, ka ndermarr veprime kundërligjore dhe ka eliminuar kompanin tone kunderligjeshem.

Se bashku me këtë kerkese bashkangjitur gjeni vemdmimin e OSHP-se, KRPP-se dhe provat tjera – sqarimi i ofruar ndaj pajisjes se kontestuar dhe karakteristikat e pajisjes dhe konfirmimin e z. Feka, për prezantim te dokumenteve fiktive nga kompania ish e rekomanduar për dhenien e kontrate.

Me nenin 62, te LPP-se lidhur me nenin 43, te Rregullores me nr 001/2022, percaktohet kure AK mund te nderpres proceduren e propkurimit:

Neni 62, par 1 dhe 2 te LPP-se percaktojne:

Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

një shkelle e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Asnjera nga dispozitat ligjore te pershkruara me sipër nuk janë konsumuar për ndërprerje dhe anulim te procedurës se prokurimit.

Madje me nenin 97, te Rregullores për prokurim publik, anulimi i aktiviteitit te prokurimit me

këto arsye konsiderohet si shkelje e rënde e ligjit:

Neni 97 - Shkeljet e rënda

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

- b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit;
- d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të percaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë...rajtim jo të barabart të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit...
- k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik

Te gjitha këto shkelje janë konsumuar dhe jo vetëm, madje për keso qeshtjesht tipike dhe identike OSHP, përmes shume vendmiesh ka ndërmarrë veprime tjera ligjore ka shqiptuar gjobe, ka inicuar procedure ne KRPP, për anulim te certifikates dhe si prove mund ti referoheni vendmit te OSHP-se te datës 11.10.2022, me nr. 397-409/22, për anulim te procedurës ne kundërshtim me nenin 62, te LPP-se, shqiptimi i gjobes ndaj AK-se, dhe inicimi për recokim te certifikates ndaj zyrtarit përgjegjës te prokurimit, perkateissht vendmi i KRPP-se, me nr. 67/2022, i datës 30.12.2022, anulimi i certifikates, dhe për këtë qeshtje kërkojmë qe OSHP, te ndermerr veprime ligjore sipas nenit 105, te LPP-se.

9. Dëmet materiale

Përkrahuraj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

SH.P.K.
Autoriteti Kontraktues